



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

AKT MARRËVESHEJJE (KONTRATE MIRËKUPTIMI)

Nr. repertori: 648


Nr. koleksioni: 430

Tirane më 23/06/2025

Ligjet referuese:

- Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Liqji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti notarial përbëhet nga 3 fletë



A2025053770046029228



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

STUDIO NOTARIALE ELIDA H. TAKE

Adresa: rr "Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane

e-mail : elidatake@yahoo.it. Mobil.0698885621

Nr. 648 .rep.nr. 430 .kol.

Taksa e pulles u pagua

AKT - MARVESHJE

Sot më datë 23.06.2025 (dymijë e njëzet e pese), para meje noterit publik, Elida H.TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time notariale të ndodhur në rr "Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme te cilat kërkuan redaktimin e akt marveshjes se lidhur mes tyre me përbajtjen që vijon:

PALA E PARE : **z. Vasil LLAJO**, shtetas shqiptar, atesia Spiro, amnesia Polikseni, lindur me 24.11.1956, ne Sarande e banues ne Tirane (sipas deklarimit të tij), madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit biometrik me nr. personal F61124009B, leshuar me dt.10.02.2022 - zotëruesh 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "INTERMEDICA CENTER" shpk, Subjekt i pajisur me NIPT – K31513084W dhe me seli ne Tirane- me cilësinë e Ortakut te Vetem te kësaj shoqërie.

PALA E DYTE : Thoma VASILI, atesia Alqi, lindur me date 24/11/1991 ne Sarande e banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit biometrik me nr. Personal J11124074J, leshuar me dt.08.08.2019, ne cilësinë e personit te besuar te Shoqerise "INTERMEDICA CENTER" shpk Tirane.

MEQENËSE EKZISTOJNË FAKTET E MËPOSHTME:

- Z. Vasil Llajo është ortak i vetëm dhe zoteron 100% kapitalin e Shoqërisë "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Person Juridik shqiptar dhe subjekt i pajisur me NIPT – K31513084W.
- Z. Vasil Llajo, rezulton kandidati fitues i zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në datën 11.05.2025, ku zgjidhet shperhën lirshëm preferencën e tyre.
- Me qëllim evitimin e papajtueshmërisë me detyrimet e deputetit, z. Vasil Llajo, ka detyrimin të marrë masat e duhura për përfaqësimin sa me te mire të zgjedhshëve dhe ushtrimin e mandatit të tij konform detyrimeve kushtetuese dhe ligjore.
- z. Vasil Llajo, i nënshtrohet detyrimeve ligjore të përcaktuara sipas Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar) dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.
- z. Vasil Llajo, në kuadër të parandalimit të konfliktit të interesave publike dhe atyre private, në zbatim të ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005, me Vendim të Ortakut të Vetëm datë 23.06.2025 **ka caktuar z. Thoma VASILI si Person të Besuar te Shoqërise "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k. Tirane.**
- z. Thoma VASILI, në cilësinë e Personit të Besuar, shpreh pëlqimin e tij dhe deklaron se propozimin sa më sipër e ka pranuar.

Me vullnet të lirë dhe të plotë, deklarojnë se kanë vendosur hartimin e kësaj Akt-Marrëveshjeje, me përbajtjen si më poshtë vijon:



NENI 1
OBJEKTI I AKT-MARRËVESHJES

Objekti i kësaj Akt-Marrëveshje është caktimi i z.Thoma VASILI në cilësinë e Personit të Besuar të Ortakut të Vetëm z. Vasil Llajo, ne lidhje me vazhdimësinë në kushte normale të aktivitetit te Shoqërisë "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k., në përputhje me Ligjin Nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar) si dhe tagrave te specifikuara si më poshtë, si pasojë e humbjes së cilësisë si "zotërues aktiv i kuotave" qe ai zoteron në shoqëri, nëpërmjet transferimit të tyre dhe kalimit në cilësinë e "Zotëruesit pasiv të kuotave".

Neni 2
AFATI I AKT-MARREVESHJES

Kjo Akt-Marrëveshje do të jetë në fuqi deri në momentin e ekzistencës së rrezikut të konfliktit të interesave, të çdo lloji për ortakun e mësipërm, sipas Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", në të kundërt, me perfundimin e këtij rreziku, apo me ndyshimin e kushteve për të cilat ky rrezik perfundon se eksiztuari, ajo mbetet pa fuqi ligjore, pa pasur nevojë palët për hartimin e ndonjë akti formal, por thjesht duke njofuar Personin e Besuar.

Neni 3
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Me qëllim menaxhimin e përgjithshëm të aktivitetit të Shoqërisë "INTERMEDICA CENTER" Sh.p.k., nga momenti i nënshkrimit të kësaj Akt-Marrëveshje, ortaku Vasil Llajo, i kalon ne menyre individuale Personit të Besuar, të drejtën e vendimmarrjes mbi 100% të kuotave të zotëruara prej tij në shoqëri.
2. Menaxhimi dhe administrimi nga Personi i Besuar do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi, i mbeshtetur ne pervojen me te mire, duke bashkëpunuar ngusht me të gjithë ortakët e shoqërisë së krijuar nga INTERMEDICA CENTER shpk, me qëllimin e vetem, konsolidimin e rezultateve positive te deritanishme financiare dhe të rritjes së rezultateve, duke ruajtur statusin aktual për sa u perket, pa drejtë tjeterësimi të tyre. Gjithashtu, me nënshkrimin e kësaj Akt-Marrëveshje, ortaku i vetëm Z. Vasil Llajo, humbet cilësinë si zotërues aktiv i kuotave që zoteron ne shoqëri, duke u kthyer në "Zotërues pasiv të kuotave te saj".
3. Z. Vasil Llajo, pavarësisht kalimit ne zotërues pasiv te kuotave te tij, gjëzon në mënyrë individuale të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë që gjëzon mbi kuotat e saj në shoqëri, përfitime të cilat do te jene te pasqyrura hollësisht në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë, por ne çdo rast, nuk mund te ushtroje asnje veprim tjeter civil mbi këtë pasuri.
4. Personi i Besuar, detyrohet të mos shkëmbejë asnjë informacion me ortakun e shoqërisë dhe as mos ndikohet nga ai për kryerjen e veprimeve me pasurinë e shoqërisë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.
5. Personi i Besuar, detyrohet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes së pasurisë së shoqërisë, me të njëjtin motivim sikur këto veprime t'i kryeheshin nga vetë ortaku i saj, duke vepruar me mirëbesim.
6. Personi i Besuar, detyrohet të kryejë depozitimin e kësaj Akt-Marrëveshjeje pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në të dhënët tregtare të shoqërisë, si dhe pranë çdo institucionit shtetëror, ku depozitimi i këtij akti është detyrim ligjor sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.



7. Ortaku ka të drejtë të rimarrë në çdo kohë të drejtat e kryerjes së veprimeve të tjera civile me pronësinë, kur, sipas ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar), kushtet që e diktuan hartimin e kësaj Akt-Marrëveshje, nuk ekzistojnë më, por gjithmonë, duke njoftuar me shkrim Personin e Besuar, në formë shkresore, brenda afateve kohore të arsyeshme.
8. Shoqëria nuk do të kryejë asnjë veprimitari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri të te ketyre, me qëllim zbatimin me korrektesi të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
SHPËRBLIMI

Palët bien dakord që shpërblimi për shërbimin që do të kryhet nga personi i besuar, do të vendoset në marrëveshje midis tyre.

Neni 5
TË NDRYSHME

Kjo Akt-Marrëveshje u hartua sipas kërkësës dhe vullnetit të të dyja palëve në 4 ekzemplarë origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore.

Sa më nuk është parashikuar me sipër, palët do t'i referohen dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Civil në fuqi, Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar) si dhe çdo ligj tjeter të detyrueshëm për palët.

Kjo Akt-Marrëveshje u redaktua nga une Notereja, u lexua palëve të cilët pasi e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, dhe pasi e kishin konsultuar edhe me konsulentët e tyre ligjorë, e nënshkruan rregullisht në prezencën time, dhe une e vërtetoj sa më sipër sipas ligjit.

PALA E PARË
Vasil Llajo

PALA E DYTË
Thoma VASILI

NOTE
Elida H. TAKE